



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

“PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT TË KOMUNIKIMEVE TREGTARE TË PAKËRKUARA”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti dhe qëllimi

Objekti i këtij ligji është krijimi i regjistrit të komunikimeve tregtare të pakërkuara (në vijim, “Regjistri”), si dhe përcaktimi i rregullave për përdorimin, aksesimin, administrimin dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Neni 2 Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- “Administrator i Regjistrit”, është Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- “Komunikime tregtare i të pakërkuara”, është marketingu i drejtpërdrejtë nëpërmjet përdorimit të telefonave fiks dhe/ose celular, mesazheve (sms), postës elektronike, si dhe çdo mënyre tjetër komunikimi, për oferta promovionale, shitje direkte, hulumtime të tregut, reklama, si dhe dhënie të informacioneve të ndryshme.

3. “Marrës i komunikimeve tregtare të pakërkuara”, është çdo person, subjekt i të dhënave personale, i cili nuk dëshiron të bëhet pjesë e komunikimeve tregtare të pakërkuara dhe për këtë arsye të dhënat e tij regjistrohen në Regjistër nga administratori i regjistrit.
4. “Ofrues shërbimi”, në kuptim të këtij ligji, është çdo person fizik dhe/ose juridik, i cili përmes komunikimeve tregtare të pakërkuara, realizon veprimtari marketingu, të tilla si, por pa u kufizuar, promovime, shitje direkte, hulumtime tregu, anketime për qëllime tregtare, si dhe/ose përcjellje informacioni tek marrësit e komunikimeve tregtare të pakërkuara me qëllim që të japë informacione për llogari të tij dhe/ose palëve të treta.
5. “Regjistër i Komunikimeve Tregtare të Pakërkuara”, ose “Regjistri”, është baza e të dhënave e plotësuar nga administratori pas kërkesës të subjekteve të të dhënave personale, e konceptuar si një shërbim në mbrojtje të këtyre të fundit, të cilët, pavarësisht publikimit të të dhënave të tyre të kontaktit në një regjistër dhe/ose platformë publike të caktuar, nëpërmjet regjistrimit në Regjistër shprehin vullnetin e tyre të drejtpërdrejtë për të mos marrë komunikime tregtare të pakërkuara nga ofruesit e shërbimeve.
6. “Të dhëna personale”, ka të njëjtin kuptim sipas përkufizimit të tyre në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 3 Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për:

- a) të gjithë ofruesit e shërbimeve që realizojnë komunikime tregtare të pa kërkuara për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë.
- b) marrësit e komunikimeve tregtare të pakërkuara, të cilët me pëlqimin e tyre, regjistrohen në Regjistër me qëllim që të mos jenë subjekt i komunikimeve tregtare të pakërkuara.

KREU II REGJISTRI, ADMINISTRIMI DHE AKSESI

Neni 4 Regjistri, përmbajtja, administrimi dhe përdorimi

1. Regjistri identifikon të gjithë ofruesit e shërbimeve në kuptim të këtij ligji, si dhe të gjithë personat, të cilët, nuk dëshirojnë të bëhen pjesë e komunikimeve tregtare të pakërkuara.
2. Regjistri përmban të dhëna që identifikojnë drejtpërdrejtë personin, si dhe numrin e tij të telefonit fiks dhe/ose celular, adresën e postës elektronike, si dhe të dhëna të ofruesit të shërbimit.
3. Regjistri nuk është i hapur për publikun.
4. Regjistri përmban të dhëna parësore dhe dytësore.
 - a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhëna të cilat grumbullohen nga kjo bazë të dhënash dhe përfshijnë:
 - i. Të dhënat e personave që nuk dëshirojnë të marrin komunikime tregtare të pakërkuara;

- ii. Të dhënat e ofrueseve të shërbimit që aksesojnë Regjistrin.
- b) Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash ku ato janë parësore:
 - i. numër personal i ID;
 - ii. emër/mbiemër;
 - iii. numër telefoni fiks dhe/ose celular.
 - iv. adresën e postës elektronike.
5. Dhënës të informacionit janë:
 - a) subjektet e të dhënave personale, të cilët nuk dëshirojnë të marrin komunikime tregtare të pakërkuara;
 - b) Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
 - c) Ofruesit e shërbimit
6. Regjistri ndërvepron me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, sipas ligjit nr. 10 325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me qëllim garantimin e identifikimit të marrësit të komunikimeve tregtare të pakërkuara.
7. Niveli i aksesit në Regjistër është si vijon:
 - a) Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka të drejta të plota administrimi në bazën e të dhënave të Regjistrit.
 - b) Ofruesi i shërbimit ka të drejtë vetëm si lexues dhe të marrë informacion për çdo person që është regjistruar në këtë Regjistër.

Neni 5 Administratori

1. Administratori përditëson të dhënat e regjistrit përmes shërbimeve të disponueshme.
2. Administratori merr të gjithë masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e të dhënave personale që përpunohen në Regjistër.
3. Ndalohet shpërndarja, publikimi, transmetimi i të dhënave të Regjistrit në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.
4. Përpunimi i të dhënave personale të personave të regjistruar kryhet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e posaçme të miratuar nga administratori.

Neni 6 E drejta e aksesit

1. Çdo ofrues shërbimi, në kuptim të këtij ligji, regjistrohet në sistem kundrejt pagesës, për të aksesuar të dhënat e marrësve të komunikimeve tregtare të pakërkuara.
2. Çdo ofrues shërbimi, përpara se të përdorë të dhënat e marra nga regjistra publik, duhet të verifikojë nëse këto të dhëna janë pjesë e Regjistrit, përpara se t'i kontaktojë. Ndalohet çdo veprimtari për qëllime marketingu tek subjektet e regjistruar në Regjistër.

3. Subjektet të cilët janë klientë të një ofruesi shërbimi, dhe kanë dhënë pëlqimin e shprehur qartë se dëshirojnë të kontaktohen për qëllime marketingu nga ky i fundit, mund të kontaktohen nga ai edhe pse mund të figurojnë të regjistruar në Regjistër

Neni 7

Mënyrat e aksesimit

1. Ofruesi i shërbimit paguan tarifa për regjistrimin dhe aksesin në Regjistër.
2. Aksesimi i çdo ofruesi shërbimi në Regjistër realizohet për 30 ditë kalendarike nga pagesa e tarifës dhe dhënies së fjalëkalimit nga administratori.
3. Tarifat për regjistrim dhe akses përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Çdo veprim i kryer me Regjistrin dokumentohet.

KREU III

MBLEDHJA, PËRPUNIMI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 8

Regjistrimi dhe revokimi i tij

1. Çdo individ mund të regjistrohet në Regjistrin e Komunikimeve Tregtare të Pakërkuara.
2. Marrësi i komunikimeve tregtare të pakërkuara, mund të revokojë në çdo kohë regjistrimin në Regjistër.
3. Revokimi depozitohet me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë administratorit.
4. Administratori bën regjistrimin/çregjistrimin përkatës dhe arkivon të dhënat e subjektit në ruajtje për një periudhë të pacaktuar.

Neni 9

Masat teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale të Regjistrit

1. Administratori merr masa teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.
2. Administratori është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Aksesimi në të dhëna bëhet vetëm nga personat e autorizuar. Administratori regjistron dhe dokumenton modifikimet, korrigjimet, fshirjet, transmetimet në të dhënat e Regjistrit.

Neni 10

Detyrimet e ofruesit të shërbimit

1. Të gjithë ofruesit e shërbimit në kuptim të këtij ligji, kanë detyrimin të regjistrohen dhe të aksesojnë Regjistrin.
2. Çdo ofrues shërbimi që kryen telefonata apo çdo mënyrë tjetër komunikimi me qëllime tregtimi dhe reklamimi, është i detyruar:
 - a) të paguajë tarifën për regjistrimin fillestar në Regjistër;
 - b) të paguajë tarifën për akses në Regjistër;
 - c) të aksesojë Regjistrin përpara se të realizojë komunikime tregtar ndaj personave;
 - d) pas aksesit në Regjistër, të heqë nga lista për kontaktim të gjithë numrat e marrësve të komunikimeve tregtare të pakërkuara të cilët janë regjistruar në Regjistër;
 - e) të garantojë identifikimin e thirrjes së tij duke i shfaqur numrin marrësit të komunikimeve tregtare të pakërkuara;
 - f) të bëjë të njohur identitetin dhe qëllimin e telefonatës në fillim të nisjes së bashkëbisedimit me marrësin e komunikimeve tregtare të pakërkuara;
 - g) në kohën e kryerjes së telefonatës, t'i tregojë me saktësi marrësit të komunikimeve tregtare të pakërkuara, që të dhënat e tij/saj personale janë marrë nga regjistra publik, ose janë publikuar nga vetë ai/ajo.
 - h) të informojë personin gjatë telefonatës, për mundësinë e regjistrimit në Regjistër me qëllim që të mos kontaktohet më.
 - i) të mos përhapë apo përdorë të dhënat personale të aksesuara në Regjistër, por t'i përdorë ato vetëm në përputhje me qëllimin e aksesit.
 - j) të realizojë komunikimin tregtar brenda intervalit kohor, nga ora 9:00 – 19:00.
 - k) të mos realizojë komunikim tregtar në fundjavë dhe gjatë ditëve të festave zyrtare.

Neni 11

Të drejtat e marrësit të komunikimeve tregtare të pakërkuara

1. Çdo marrës i komunikimeve tregtare të pakërkuara regjistrohet pa pagesë në Regjistër nëse nuk dëshiron të kontaktohet nga ofruesit e shërbimeve. Marrësi i komunikimeve tregtare të pakërkuara nuk mund të regjistrojë numra kontakti që nuk i përkasin atij/asaj.
2. Marrësi i komunikimeve tregtare të pakërkuara mund të përditësojë apo korrigjojë të dhënat e tij në Regjistër.

KREU IV

HETIMI ADMINISTRATIV, SANKSIONET DHE E DREJTA E ANKIMIT

Neni 12

Hetimi Administrativ

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kryen hetim administrativ kryesisht dhe/ose mbi bazë ankese për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Procedurat e konstatimit, shqyrtimit dhe ankimit janë ato të parashikuara në ligjin për kundërvajtjet administrative.

Neni 13 **Sanksionet**

Veprimet e kryera në kundërshtim me nenin 10 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, si më poshtë:

- a) mos përmbushja e detyrimeve të parashikuara në shkronjën “c” dhe “j” të nenit 10, dënohet me 100.000 deri në 1.000.000 lekë;
- b) mos përmbushja e detyrimeve të parashikuara në shkronjën “e”, “f”, “g” dhe “h” të nenit 10, dënohet me 50.000 deri në 300.000 lekë;
- c) mos përmbushja e detyrimeve të parashikuara në shkronjën “j” dhe “k” të nenit 10, dënohet me 50.000 deri në 150.000 lekë.

Neni 14 **E drejta e ankimit dhe ekzekutimi i masave administrative**

1. Masat administrative gjobë parashikuara në këtë ligj vendosen nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe përbëjnë titull ekzekutiv.
2. E drejta e ankimit dhe ekzekutimi i masave administrative gjobë të parashikuara në këtë ligj, kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU V **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 15 **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 4 të nenit 5, të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Financave dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që brenda 2 (dy) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të pikës 3 të nenit 7, të këtij ligji.

ANeni 16 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

ELISA SPIROPALI